Parandalohet ngjarje e rëndë kriminale/ Sekuestrohen 2 mina me telekomandë, kallashnikov dhe municione, pranga të riut në Mirditë

24 Janar, 2024 10:28

Madhësia e tekstit:

Parandalohen ngjarje të rënda kriminale që do të kryheshin me mina me telekomandë. Finalizohet nga Komisariati i Policisë Mirditë, operacioni policor i koduar "Safe City". Sekuestrohen 2 mina me telekomandë, 1 kallashnikov dhe municion luftarak. Vihet në pranga 28-vjeçari Marian Gjoka që transportonte minat dhe mbante në banesë 1 armë zjarri kallashnikov dhe municion luftarak.

Shërbimet e Komisariatit të Policisë Mirditë, në vijim të megaoperacionit kombëtar "Sundimi i ligjit" dhe në bazë të informacioneve të siguruara nga inteligjenca policore, se një shtetas po transportonte mina me telekomandë që do të shërbenin për të kryer krime kundër personit, kanë organizuar dhe finalizuar operacionin policor të koduar "Safe City".

Në hyrje të qytetit të Rrëshenit, shërbimet e Policisë kanë lokalizuar shtetasin e dyshuar i cili lëvizte me këmbë, në drejtim të qytetit, dhe kanë ndërhyrë menjëherë. Si rezultat u bë arrestimi në flagrancë i shtetasit M. Gj., 28 vjeç, banues në Qafë Unazë, njësia administrative Rubik, Mirditë, rezident në Malin e Zi.

Shërbimet e Policisë, gjatë kontrollit në çantën e shpinës së 28-vjeçarit, gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale, 2 mina me telekomandë, me lëndë plasëse C4. Në vijim të veprimeve procedurale, gjatë kontrollit të kryer në banesën e këtij shtetasi, është gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale 1 armë zjarri kallashnikov dhe një sasi municioni luftarak. Nga veprimet e para hetimore dyshohet se 2 minat me telekomandë, 28-vjeçari i ka siguruar në Malin e Zi, ku ishte i punësuar.

Në bashkëpunim me Prokurorinë, vijon puna për dokumentimin e plotë të rrethanave të rastit dhe për identifikimin e shtetasve të tjerë të përfshirë në këtë veprimtari kriminale. Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.

Për t'u bërë pjesë e grupit "**Balkanweb**" mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

TË NGJASHME

"Joe the Genocide", protestuesit pro Palestinës ndërpresin fjalimin e Biden dhe bëjnë thirrje për armëpushim në Gaza
24 Janar, 2024

Fillon sot greva 6-ditore e hekurudhave gjermane, frikë për ndikimin serioz në transport dhe industri
24 Janar, 2024

TË FUNDIT NGA TË GJITHA

"Do të shkoj te mjeku", zhduket në rrethana misterioze 33-vjeçarja shqiptare në Greqi
24 Janar, 2024

Theu masën "Arrest shtëpie" dhe vodhi 8 kompjutera në një gjimnaz, arrestohet 25-vjeçari në Malësinë e Madhe
24 Janar, 2024

"Zhvillon takime të rregullta me Moskën", diplomati slloven për situatën në Ballkan: Serbia vijon bashkëpunimin e ngushtë me Rusinë
24 Janar, 2024

Osimhen nuk fshihet më, nigeriani "tradhton" Napolin, zbulon të ardhmen e tij
24 Janar, 2024

Fotot seksi të Sydney Sweeney në Instagram rrisin audiencën e saj, aktorja 26-vjeçare kalon 16 milionë ndjekësit
24 Janar, 2024

Vendimi për përjashtimin e dinarit serb, DASH thirrje Kosovës: Duhet më shumë kohë, konsultohuni me partnerët!
24 Janar, 2024

KATEGORIA VIDEO

"Joe the Genocide", protestuesit pro Palestinës ndërpresin fjalimin e Biden dhe bëjnë thirrje për armëpushim në Gaza
24 Janar, 2024

Nusja akuzon hapur Cher: Organizoi rrëmbimin e djalit të saj për të pasur kujdestarinë e tij
24 Janar, 2024

"Gërdeci"/ Pritet të pyeten dëshmitarët, mbahet sot seanca gjyqësore për ish-ministrin Mediu
24 Janar, 2024

VIDEO/ Chelsea kualifikohet mes spektaklit në finalen e EFL Cup, "ndez" Broja
23 Janar, 2024

VIDEO/ Protagonist në EFL CUP, Broja realizon gol pas 15 minutash lojë
23 Janar, 2024

Ish-kryeministri në SPAK, Boçi: Berisha rrëzoi alibinë se nuk respekton institucionin, Prokuroria pretendonte që...
23 Janar, 2024

Download on the App Store | GET IT ON Google Play

Kerko ketu

LAJMET E FUNDIT

"Joe the Genocide", protestuesit pro Palestinës ndërpresin fjalimin e Biden dhe bëjnë thirrje për armëpushim në Gaza
24 Janar, 2024

Nusja akuzon hapur Cher: Organizoi rrëmbimin e djalit të saj për të pasur kujdestarinë e tij
24 Janar, 2024

"Gërdeci"/ Pritet të pyeten dëshmitarët, mbahet sot seanca gjyqësore për ish-ministrin Mediu
24 Janar, 2024

VIDEO/ Chelsea kualifikohet mes spektaklit në finalen e EFL Cup, "ndez" Broja
23 Janar, 2024

VIDEO/ Protagonist në EFL CUP, Broja realizon gol pas 15 minutash lojë
23 Janar, 2024

Ish-kryeministri në SPAK, Boçi: Berisha rrëzoi alibinë se nuk respekton institucionin, Prokuroria pretendonte që...
23 Janar, 2024

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE

@balkanweb

© 2024 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.